



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbal i mbajtur më 26 shtator 2014, në mbledhjen e IX-të
(nëntë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.05'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht Afrim Shabani, Bahri Blakçori, z. Islam Revuçi Fidan Rekalju, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahu – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuromi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe z. Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. **Durim Salihu**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, propozoi që në rend dite të përfshihen edhe:

- **Propozimi i vendimeve për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në Tokë ndërtimore (Sipas kërkesave të Salih Tullarit – Tërrnavë dhe Naip Plakollit – Letanc)** dhe shtoi, sot e kemi marrë një konfirmim nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë që nëse e bëjmë planin zbatues për rregullimin e shtratit të lumbit Llap mund të aplikojmë dhe kemi gjasa të jemi përfitues të donacionit për mbrojtjen e ambientit, andaj propozoj që listës së projekteve prioritare t'i shtohet edhe projektin:

- **Rregullimi i shtratit të lumbit Llap në qytet, 20.000 €.**

z. **Haki Rudari**, theksoi, konsideroj se në rend dite duhet të përfshihet edhe:

-Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2014/2015 dhe shtoi, ne që punojmë në sektorin e Arsimit jemi të mendimit se kjo çështje është dashtë të shqyrtohej edhe më parë, por siç thotë një fjalë popullore më mirë vonë se të mos shqyrtohet fare.

z. Kadri Avdiu, theksoi, e mbështes propozimin e parafolësit ngase është mirë që këshilltarët e Kuvendit të informohen për përgatitjet e bëra për fillimin e vitit të ri shkollor.

Gjithashtu jam i interesuar të di se çfarë është ndërmarrë nga Drejtoria kompetente lidhur me një rast në fshatin Tërrnavë, të cilin e kam ngritur edhe në këtë Komitet e që ka të bëjë me dëmtimin e shtëpisë nga vërvshimet, rast të cilin e ka vërtetuar një komision se shtëpia nuk i plotëson kushtet për banim e për këtë jam bindur personalisht se ajo familje jeton në kushte shumë të vështira.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, lidhur me propozimin e z. Haki Rudarit, propozim të cilin e përkrahu edhe z. Kadri Avdiu, jam i mendimin se pa u përgatitur paraprakisht Informata përkatëse nga Drejtoria e Arsimit nuk mund të debatohet për çështjen e propozuar, andaj këtë ne mund ta marrim si kërkesë që kjo informatë të përgatitet dhe shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit.

Gjithashtu për çështjen e ngritur nga z. Kadri Avdiu, përgjigjen duhet ta jep Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

z. Haki Rudari, theksoi, çështja e arsimit është shumë e rëndësishme dhe ka çështje për të cilat do duhej të debatojmë ngase kjo është në interes të qytetarëve e në veçanti në interes të nxënësve.

z. Fadan Rekaliu, theksoi, në mënyrë të qartë kryesuesi z. Mehmet Gashi, e arsyetoj përsë çështja e propozuar nga parafolësi nuk mund të përfshihet në rend dite të mbledhjes së sotme, pra edhe ne jemi që të shqyrtohet informata për fillimin e vitit të ri shkollor 2014/2015, mirëpo jemi të mendimit se në mbledhjen e nesërme të kërkojmë që të përgatitet informata e cekur në mënyrë që të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme.

Fillimisht në votim u vu propozimi i z. Haki Rudarit dhe pas votimit u konstatua se i njëjtë nuk u miratua ngase për ishin 5 vota ndërsa kundër ishin 6 vota.

Rendi i propozuar i ditës u miratua me shumicë votash përkatësisht 10 vota për dhe një votë kundër së bashku me propozimin që në rend dite të përfshihen edhe:

- **Propozimi i vendimeve për destinim të pérhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Sipas kërkesave të Salih Tullarit – Tërrnavë dhe Naip Plakollit – Letanc),** dhe

Listës së projekteve prioritare t'i shtohet edhe projekt:

- **Regullimi i shtratit të lumi Llap në qytet, 20.000 €.**

2. Shqyrtimi i Ekstrakteve të procesverbaleve të mbajtura në mbledhjet e KPF – së më 1 korrik 2014, 17 korrik 2014 dhe 30 korrik 2014

z. Rafet Llapashtica, theksoi, kam vërejtje parimore lidhur me vonesën e ekstrakteve të procesverbaleve, jemi njoftuar për disa pengesa të deritashme mirëpo konsideroj se në të ardhmen ekstraktet duhet të dorëzohen për shqyrtim në mbledhjen e radhës, gjithashtu duhet pasë kujdes më të shtuar në mënyrë që të evitohen disa gabime teknike dhe gjuhësore.

Ekstraktet e procesverbaleve u miratuan njëzëri.

3. Propozimi i Vendimit për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës dhe projektet prioritare për vitet 2015 – 2017

- z. Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.
- z. Durim Salihu**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, i paraqiti sqarimet për projektet e propozuara prioritare në kuadër të Drejtorisë së cekur.
- z. Faik Muçiqi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, i paraqiti sqarimet për projektet e propozuara prioritare në kuadër të Drejtorisë së cekur.
- z. Rafet Llapashtica**, theksoi, lista e projekteve të propozuara prioritare na është dorëzuar dhe në shikim të parë vërehet se ka projekte prioritare të parealizuara dhe barten nga viti në vit, siç është asfaltimi i rrugës në fshatin Surdull në shumë 40.000 €, projekt i cili është në prioritete dhjetë vitet e fundit. Çështje tjetër shqetësuese shpërndarja racionale e projekteve në terren në mënyrë që investimet të jenë gjithëpërfshirëse, prej vitit 2010 në fshatin Bradash për çdo vit ka pasë projekte për asfaltimin e rrugëve, edhe ata qytetarë e meritojnë asfaltimin e rrugëve por jam i mendimit se asfaltimi i rrugëve në atë fshat është 90% më i mirë se në mjediset tjera, rast tjetër është në fshatin Batllavë, në lagjen e Ratkocerëve për një shtëpi është vazhduar asfaltimi i rrugës deri te shtëpia e një personi vetëm që ka qenë mik i dikujt, ndërsa pjesa tjetër ka mbetur në lloç, kjo sipas meje nuk është qeverisje e mirë.

Për të gjitha projektet e parealizuara Drejtoritë përkatëse janë arsyetuar se komunitetet nuk i kanë hartuar projektet zbatuese, ndërsa në projektbuxhet janë paraparë shuma të caktuara për hartimin e projekteve, nëse mendojmë të punojmë në aspektin gjithëpërfshirës ose duhet të parashohim mjete për hartimin e të gjitha projekteve zbatuese ose për asnjë në mënyrë që të mos vijmë në situatë që dikujt t'i hartohet projektet zbatues e dikujt jo. Në vitin 2015 janë paraparë 20.000 € për hartimin e projekteve zbatuese, lidhur me këtë jam i interesuar të di se për cilat projekte konkrete parashihen këto mjete. Gjithashtu kërkoj sqarime se sa pagesa janë bërë prej vitit 2010 e deri tash për projekte të papërfunduara dhe projekte të cilat nuk kanë qenë në prioritet.

Gjithashtu problem buxhetor për kategorinë e pagave do të ketë për shkak të stërngrarkimit me punëtorë sipas kontratës mbi vepër, për këtë duhet pasë kujdes.

Nuk është etike, së paku morale, të orientohet për dëshirë të ndokujt ngase mënyra e këtillë është qeverisje e keqë të cilën ndokush e krijon me vetëdije.

Nëse në një lokalitet të caktuar nuk janë bërë investime që nga viti 2010, shtrohet pyetja si mund të kërkosh nga ata qytetarë të paguajnë tatimin në pronën e paluajtshme, në këtë kontekst në një mbledhje të ardhshme do ta sjellë një listë të qytetarëve të cilët tatimin në pronën e paluajtshme prej vitit 2010 e kanë zero zero dhe ata për çfarë të bisedojnë me përgjegjësit institucional.

Në fund kërkoj që të hënën në mbledhjen e Kuvendit të më jepet lista e pronave të Komunës, të atyre që shfrytëzohen dhe atyre që nuk janë dhënë në shfrytëzim,

këtë e kam kërkuar thuajse në dhjetë mbledhje, më është premtuar por ende nuk më është dhënë, përndryshe pa dashje më duhet të ndjek një rrugë tjetër, ose më thoni jo nuk do ta japim listën e pronave të kërkuara.

z. Haki Rudari, theksoi, edhe për Grupin e këshilltarëve të LVV-së mënyra e realizimit, planifikimit dhe shpërndarjes ndikon në mirëqenien e qytetarëve dhe të Komunës si dhe zhvillimin e tërësishëm.

Pas një analize të bërë konstatojmë se projektbuxheti për vitin 2015 nuk shpreh kërkosat dhe nevojat e qytetarëve të Podujevës dhe nuk shfrytëzohet potenciali lokal për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, madje ky buxhet komunal është hartuar dhe planifikuar në mënyrë jo të mirë me një pjesëmarrje shumë të vogël të qytetarëve, ne jemi në dijeni për këtë. Planifikimi dhe ndarja e buxhetit, po ashtu, nuk i mbulon nevojat dhe kërkosat e qytetarëve dhe zonave të ndryshme, të disa zonave po por të disa zonave nuk i mbulon ose fare nuk investohet.

Ky projektbuxhet kryesisht është i orientuar në asfalt dhe kanalizime, që në parim e përkrahim, mirëpo mungojnë investimet në bujqësi, arsim, kulturë, çështje sociale, mjedis jetësor, turizëm e sektorë të tjerrë.

Te Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, 25.000 € janë për hartimin e projekteve, pajtohem me këtë por me kusht që projektet të hartohen për të gjitha mjediset përkatëse në mënyrë që të mos bëhen dallime në mes të qytetarëve.

Për projekte të papërfunduara janë paraparë 132.283 € do të ishte mirë që kjo çështje të specifikohej në mënyrë që këshilltarët të jenë në dijeni se për cilat projekte bëhet fjalë.

Te Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit do të përqendrohem te rregullimi i rrëthojës dhe platosë në tregun e qytetit, në shumë 30.000 € mjete nga të hyrat vetanake, mirëpo kur të dalim te Drejtoria e Arsimit do të shikojmë se a kemi të hyra apo jo.

Vërejtje tjetër e imja është edhe te mirëmbajtja e rrugëve në shumë 40.000 € meqë për meremetimin e rrugëve me zhavorr janë 54.000 €, kjo është një diskrepancë ngase më shumë shpenzohet për zhavorr se sa për mirëmbajtjen e rrugëve të asfaltuara.

Për rregullimin e infrastrukturës dhe mirëmbajtjes së varrezave janë paraparë 20.000 € nga të hyrat vetanake, e mbështes në tërsi por konsideroj se duhet të specifikohet se çfarë dhe ku do të punohet, në këtë drejtim ka nisma nga qytetarët që të grumbullohen mjete për mirëmbajtjen e varrezave në veçanti në pjesën e qytetit te tjegullorja.

Te Drejtoria e Arsimit nuk e kemi asnjë të hyrë vetanake derisa për zgjerimin dhe renovimin e objekteve shkollore janë paraparë 195.050 €, ndërsa të hyra vetanake nuk figuron asnjë cent, lidhur me këtë jam i mendimit se arsimi është dashtë të ketë prioritet më shumë dhe nëse marrim një rast konkret, nga të hyrat vetanake, për ndërtimin Qendrës së Kulturës janë 129.912 €, mirëpo po e përsëris se nga të hyrat vetanake për arsim nuk është paraparë asnjë cent, andaj si konkludim i gjithë kësaj konsideroj se ky projektbuxhet nuk i pasqyron interesat e qytetarëve, nuk ka shpërndarje gjithëpërfshirëse dhe do duhej të rishikohet edhe një herë.

z. Kadri Avdiu, theksoi, fillimisht kërkoj sqarime përse te pozicioni i Kuvendit nuk është paraparë numri i stafit të punës derisa kjo është bërë te të gjitha pozicionet tjera dhe përse për Kuvendin në vitin 2016 shuma zbritet afro 20.000 €.

Te përshkrimi i projekteve prioritare për vitin 2015, te Drejtoria e Urbanizmit, në materialet e mëhershme kanë qenë të propozuara disa projekte mirëpo në këtë material kemi ndryshime, projektet prej numrit rendor 1 deri në numrin 6 kemi vazhdime të projekteve me shuma përkatëse, mirëpo nuk figurojnë shumat për punët paraprake që janë bërë.

Ekzekutivi i Komunës do duhej të ketë parasysh që ka fshatra në të cilët nuk është investuar asnjë cent në tetë vitet e fundit dhe nuk është e drejtë as ligjore e as morale që në fshatra të caktuara të mos investohet kur dihet se buxheti nga granti i Qeverisë ndahet për kokë të banorëve dhe më e keqja është se në disa fshatra nuk parashihen investime as në periudhën e ardhshme trevjeçare, kjo është diskriminim.

Shumica e buxhetit për vitin 2015 ndahet për mjediset nga vijnë përfaqësuesit e Ekzekutivit të Komunës siç janë fshatrat Dumnicë, Bradash, Llaushë, Dobratin, dhe Llapashticë, konsideroj se kjo nuk është në rregull ngase në jemi përfaqësues të qytetarëve dhe në momentin që kemi marrë mandatin ne duhet të mbrojmë të drejtat e qytetarëve, unë nuk do t'i parashtroja këto vërejtje sikur projektet, në aspektin territorial, të ishin gjithëpërfshirëse.

Në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, për projektin e ndërtimit të kanalizimit fekal në fshatrat Popovë, Peran, Batllavë dhe Halabak janë paraparë 25.000 €, mirëpo unë nuk e kuptoj se çfarë mund të punohet me ato mjete në katër fshatrat e cekura, por jemi në dijeni se pasi që projektet prioritare po miratohen në Kuvend, Ekzekutivi i Komunës në mënyrë të kundërligjshme po e merr të drejtën e ndryshimit të projekteve.

Shtrohet pyetja, a jemi ne si Kuvend, si Ekzekutiv apo si institucione të Komunës në nivel të detyrës, a jemi duke i kryer obligimet, ne kemi mbetur thuajse me nivelin e njëjtë të arkëtimit të të hyrave vetanake, a jemi ne në dijeni se shfrytëzohen prona të Komunës dhe nuk arkëtohet qiraja përkatëse, andaj ne duhet të angazhohemi në përm bushjen e të gjitha përgjegjësive.

Gjithashtu me rëndësi të veçantë është të dihet se sa kemi borxhe të viteve të mëparshme, jo të fshihen borxhet por në mënyrë të saktë të informohemi sa është shuma e borxheve të vjetra, dhe shpresoj se viteve të ardhshme nuk do të veprohet ashtu siç është vepruar deri tash në mënyrë që të dalim prej kësaj gjendjeje.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, i përshëndes hartuesit e projektbuxhetit për vitin 2015, është një projektbuxhet i cili përfshinë të gjitha fushat e jetës së qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe besoj se sado pak do të përmirësohet mirëqenia e bashkëqytetarëve tanë. Ajo çfarë është për të ardhur keq është zvogëlimi i buxhetit për investime kapitale e me këtë edhe zvogëlimi i numrit të projekteve, mirëpo kjo nuk është pasojë e keqmenaxhimit por është një barrë të cilën komunave ua ka vu Qeveria qendrore me rritjen e pagave 25%. Përkundër kësaj unë besoj se Ekzekutivi i Komunës i ka paraparë projektet të cilat janë më emergjente dhe më në nevojë për qytetarët e Komunës së Podujevës.

z. Afrim Shabani, theksoi, me kujdes e kam lexuar këtë material dhe në veçanti jam interesuar për investimet në shëndetësi dhe konsideroj se në përgjithësi projektet e propozuara janë të mirëseardhura për qytetarët e Komunës së Podujevës.

z. Naim Çunaku, theksoi, materiali për të cilin jemi duke debatuar është një dokument përkatësish propozim i projekteve prioritare i cili nuk ndryshon nga projektet të cilat i kemi pasë viteve të mëparshme, kur e them se nuk ndryshon mendoj në aspektin e dhënies së prioriteteve mjediseve të caktuara, pa dëshirë që të flas në mënyrë kritike por nuk ke si të mos flasësh kur kemi grumbullim të projekteve në mjedise të caktuara dhe kemi anashkalim të mjediseve të caktuara, përsë dhe deri kur në këtë mënyrë unë nuk e kuptoj. Mënyra e këtillë e përcaktimit të prioriteteve mbështetet vetëm në kriterin se personat e caktuar vijnë apo i përkasin lokaliteteve përkatëse mirëpo për mua kjo mënyrë nuk është në rregull. Në cilësinë e anëtarit të komitetit për Politikë dhe Financa, as unë nuk dua të bëjë përjashtime ngase nuk mund të pajtohem me faktin se në mjedise të caktuara investohen së paku qindra mijëra euro ndërsa në mjedise të caktuara ndonjëherë parashihen 30.000 € apo 60.000 € dhe këto mjete i ridestitojnë prapë, pra në mjedise të caktuara nuk bëhen investime. Unë vijë prej në fshati cili i ka 2000 banorë, mbi 200 shtëpi, dhe edhe ai fshat ka nevojë për infrastrukturë rrugore dhe është fshat i cili nga aspekti gjeografik sigurisht duhet të ketë investime krahasuar me një fshat të pjesës malore, pa dashur ta nënçmoj zonën malore.

Në fjalën e hyrjes drejtori z. Isuf Latifi, e përmendi Zyrën e Vendit në Lluzhan, të flasim me fakte ndërtohet Zyra e Vendit në Herticë, shpenzohen mjete dhe nuk funksionalizohet kurrë, i njëjtë rast është edhe në Pollatë, Zyra të Vendit kemi në Orllan, Lupç etj por nuk kemi në Lluzhan përkundër faktit se është mega qendra e dytë në Komunë. Zyra e Vendit në Lluzhan ka qenë në prioritete që nga viti 2009 dhe për çdo vit është hequr nga prioritetet, ndërsa tash duke u referuar në fjalën hyrëse të drejtorit z. Isuf Latifit sërisht do të hiqet nga prioritetet e vitit 2015 dhe në vend të fshatit Lluzhan Zyra e Vendit do të ndërtohet në fshatin Gllamnik, kjo konsideroj se nuk është në rregull, e imja është ta ngriti si shqetësim këtë çështje por e juaja si shumicë është që të vendosni.

U përmend se ky projektbuxhet do të lehtëson jetën e qytetarëve të Komunës, nuk ka se si të mos e lehtësoj por konsideroj se dikujt ia lehtëson por dikujt ia rëndon, kur e them këtë mendoj në atë se shumë pak jemi duke bërë për mbrojtjen e mjedisit dhe në vazhdimësi jemi duke e degraduar mjedisin ku jetojmë. Pajtohem që në projektbuxhet është paraparë një shumë e caktuar për ndërtimin e kolektoreve, nëse realizohen këtë projekte e pëershëndes, mirëpo forma e propozimit më jep të kuptoj se kjo është sa për arsyetim të një pjese të caktuar të mjeteve të cilat në fazën e mëtutjeshme do të ridestinohen, këtë e them ngase projektet përkatëse, sipas mendimit tim, janë më shumë dëshirë se sa projekte të cilat mendohet të realizohen.

Duke i parë të gjitha këto konsideroj se propozimi i këtij projektbuxheti nuk e meriton mbështetjen.

z. Kumrie Hoti, theksoi, nga drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit kërkoj informacione se në cilën fazë është realizimi i projektit për asfaltimin e pjesës së mbetur të rrugës në fshatin Revuç, gjithashtu dua t'ju informoj se qytetarët e atij mjedisit i kanë përbushur obligimet e tyre.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, theksoi, fillimisht po ndërlidhem në pyetjen e z. Kumrie Hotit dhe shtoi, është e vërtetë se fshati Revuç e kanë kryer projektin zbatues, një pjesë e projektit është reduktuar për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore mirëpo realizimi i këtij

projekti është në fazën përfundimtare të procedurave të prokurimit, kontrata është nënshkruar dhe mjetet janë zotuar, andaj besoj se punimet do të fillojnë në një afat të shkurtër.

Publikisht e them se në punën time në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës janë të barabartë dhe në asnjë rast nuk bëjë dallime në aspektin e përkatësisë së tyre partiake.

Sa i përket pyetjes së Rafet Llapashticës që ka të bëjë me hartimin e projekteve zbatuese mund të them se për Drejtorinë të cilën e menaxhoj janë paraparë 20.000 € nga granti i Qeverisë dhe 5.000 € nga të hyrat vetanake, kjo shumë është paraparë për hartimin e planeve rregulluese urbane dhe planeve zbatuese për rregullimin e hapësirave publike, mirëpo me përgjegjësinë më të madhe them se nuk është investuar në asnjë rast për hartimin e planit zbatues për ndonjë komunitet.

U përmend fshati Bradash, lidhur me këtë mund t'ju them se kanë ardhur përfaqësuesit e atij fshati me projekte zbatuese të gatshme dhe duke u bazuar në këtë këto projekte kanë pasë përparësi dhe janë përfshirë në projekte prioritare.

Sa i përket fshatit Batllavë projekti është me kontratë dyjeçare ashtu siç janë edhe projektet për fshatrat Dumosh me gjatësi të gjithmbarshme të rrugëve prej 7.399 m. dhe fshati Obrançë – Katunishtë që është afersisht 6 km. projekte të cilat kanë mungesë të caktuar të mjeteve buxhetore.

Fshati Letanc, për disa lagje, nuk i ka përgatitur planet zbatuese e kjo është arsy që nuk ka pas mundësi të realizohen projektet përkatëse por lagjet të cilat i kanë përgatitur projektet zbatuese janë përfshirë në procedurën e realizimit.

Në fshatin Llugë janë disa projekte po ashtu me kontratë dyjeçare.

Gjatë diskutimit z. Naim Çunaku e përmendi se për asfaltimin e rrugëve në fshatin Dumanicë janë bërë pagesa në shumë 300.000 €, lidhur me këtë ju njoftoj se me marrjen e detyrës së drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e kam gjetur një kontratë dyjeçare për vitet 2013 dhe 2014 e ka të bëjë me disa rrugë të lagjeve në Dumanicë të Poshtme dhe disa lagjeve në Dumanicë të Epërmë. Në Dumanicë të Poshtme dhe Llaushë, për vitin 2015, janë paraparë disa projekte prioritare, arsyet kryesore që janë përfshirë është se për disa projekte, projektet zbatuese janë që nga viti 2009. z. Haki Rudari u interesua për çështjen e projekteve të papërfunduara e këto janë kontratat e nënshkruara me kompanitë përfituese në procedurën e prokurimit, konkretisht janë projektet për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Livadicë, Bajçinë (lagjja e Sogojevëve) e Revuç, për të cilat mungojnë mjete për realizimin e plotë të atyre projekteve.

E kam thënë edhe më parë dhe po e përsëris, jam i hapur për bashkëpunim me çdo person të vullnetit të mirë, duke e përfshirë edhe opozitën, në mënyrë që të gjitha aktivitetet t'i zhillojmë bashkërisht dhe sa më suksesshëm.

z. Naim Çunaku, theksoi, më vjen mirë që për disa lokalitetet e ke komplet të regjistruar gjendjen përkatësisht gjatësinë e rrugëve të lagjeve të caktuara, poenta e kritikës tonë ishte se ne jemi në dijeni se ka lagje që e kanë përfunduar asfaltimin e rrugëve por në anën tjetër ka fshatra që nuk janë prekur fare. Parafolësi tha se nuk ka qenë në dijeni se në fshatin Llugë janë dy lagje Zhitia, mirëpo çfarë kriteri është nëse dy shtëpi të njërsës lagje Zhitia kanë arritur ta bëjnë projektin zbatues

dhe ju shkoni e intervenoni atje ku janë dy shtëpi dhe anashkalohet lagjja ku janë 15 shtëpi të cilat nuk e kanë pas projektin zbatues.

Ka tri vite që kam intervenuar te drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit që të intervenoj të paktën me zhavorr në fshatin Llugë përkatësisht në rrugët e lagjeve Zekolli, 500 m. Bulliqi, 500 m. Çunaku janë dy rrugë nga 1.000 m. Mavriqi 500 m dhe dy lagje Zhitia rrugët nga 500 m. që gjithsej rrumbullakohen në 4 km. dhe nuk është bërë asgjë.

Konsideroj se në projektbuxhet do duhej të parashihet shuma e caktuar për hartimin e të gjitha projekteve zbatuese dhe pas kësaj të paraqitej propozimi për miratimin e projekteve prioritare.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, jam i mendimit se në këtë mbledhje do duhej të ishin të pranishëm të gjithë drejtorët e Drejtorive ngase ne nuk mund të debatojmë për Drejtorinë e Arsimit kur drejtori nuk është i pranishëm.

Shtrohet pyetja si mund të realizohen projektet prioritare në shumë afro 3 milion euro kur për hartimin e projekteve zbatuese janë paraparë 20.000 €.

Në zonat të cilat janë orientuar investimet që kryesisht janë fshatrat Bradash, Bajçinë Dobratin dhe Dumnicë dhe merrni të dhënat nga Zyra e tatimit në pronë, janë borxhlinjtë më të mëdhenj të Komunës, ndërsa në fshatrat që i përmbushin obligimet ndaj Komunës nuk investohet fare.

z. Haki Rudari, theksoi, drejtori z. Durim Salihu, në njëfarë mënyre iu drejtua opozitës për qëndrimin që ka ndaj këtij dokumenti, lidhur me këtë dëshiroj t'i them se i vetmi qëllim i gjithë kritikave tonë është interes i qytetarëve, jam mbështetës i çdo investimi që shkon në interes të qytetarëve por jam kundër çdo investimi me ngjyrime politike.

z. Faik Muçiqi, theksoi, kjo çështje është shqyrtuar në Kuvend, ky propozim ka pak ndërhyrje dhe nuk vërejta ndonjë propozim të ri përveç propozimit të z. Rafet Llapashticës, lidhur me projektin e kanalizimit në fshatin Dyz, projekt të cilin nuk kemi mundur ta fillojmë ngase shuma e propozuar nuk ka qenë e mjaftueshme meqë kanalizimi nuk mund të kryhet vetëm për një apo dy lagje por duhet të kryhet për gjithë fshatin, mirëpo do të shqyrtohen mundësit që ky projekt të realizohet vitin e ardhshëm.

Mjetet e parapara për hartimin e projekteve zbatuese nuk parashihen për hartimin e projekteve për lokalitete të caktuara por për lokalitetet të përgjithshme siç është hartimi i kolektorit Gllamnik – Penuhë – Kunushec, ngase asnë lokalitet nuk e merr përsipër hartimin e projektit.

Sigurisht e keni vërejtur se projektet janë të shpërndara në 27 fshatra, andaj nuk mund të thuhet se projektet janë koncentruar vetën në disa fshatra.

z. Isuf Latifi, theksoi, pajtohem se mjetet e parapara për projekte prioritare nuk i plotësojnë nevojat e qytetarëve e sigurisht se po të ishin edhe 30 milion nuk do t'i plotësonin të gjitha nevojat e qytetarëve, mirëpo duhet të përballemi me mundësit që i kemi.

Çështja e zvogëlimit të buxhetit për vitet 2016 – 2017, ju informoj se ne jemi duke punuar sipas instrukSIONEVE të Qeverisë, pra kufijtë buxhetor janë të caktuar.

Në vazhdim sqaroi veç e veç grantet e parapara në projektbuxhet.

z. Kadri Avdiu, theksoi, gjatë debatit ka pas pretendime kinse opozita po bënë pengesa, lirshëm mund të them se opozita kurrë nuk ka qenë pengesë por ka

qenë shumë konstruktive, e hapur dhe çdo herë me propozime në të mirë të qytetarëve.

Para dy viteve, në mënyrë urgjente e kemi miratuar propozimin për themelimin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtori e cila 9 muaj nuk ka funksionuar fare.

Mos u mundoni që lëshimet dhe gabimet e keqeverisjes 14 vjeçare t'i bartni te opozita ngase çdo iniciativë që ka qenë në të mirë të komunës dhe qytetarëve e kemi mbështetur dhe nuk keni argument se ne kemi qenë kundër.

z. Abaz Llugaliu, theksoi, dëshiroj t'i përgjigjem z. Rafet Llapashticës, lidhur me atë që tha se në fshatin Sallabajë prona komunale është dhënë me çmim qesharak prej 0.05 cent dhe shtoi, kjo pronë është dhënë në shfrytëzim në procedurat e parapara përmes Komisionit përkatës, Komisioni në të cilin ka qenë edhe përfaqësuesi i juaj. Përndryshe nëse llogaritet shuma e gjithmbarshme vjetore i bie se për 34 ari shfrytëzuesi paguan 174 € e kjo për tokë bujqësore është qira mjaftë e lartë.

z. Naim Çunaku, theksoi, drejtori në përgjigjen që ia dha z. Rafet Llapashtica tha, ju e keni pas përfaqësuesin e juaj, në këtë rast aludoi drejtpermëdrejt te unë, është e vërtetë se jam anëtar i atij Komisioni të ngritur nga Kuvendi. Është e vërtetë se paluajtshmëria në Sallabajë është dhënë në shfrytëzim nga Komisioni, mirëpo në përpilimin e kushteve për dhënie në shfrytëzim, Komisioni apo të paktën unë nuk kam qenë i ftuar dhe nuk kam marrë pjesë.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, ju falënderoj për debatin e zhvilluar, janë sqaruar shumë çështje dhe jam i mendimit se nëse ka mbet çfarëdo çoftë pa sqaruar mund të shkojmë në zyra të drejtoreve për sqarime plotësuese lidhur me çdo projekt.

z. Naim Çunaku, theksoi, kur debatuam për projekte prioritare unë e bëra një propozim konkret e ai është që të ndahet një shumë për hartimin e projekteve zbatuese të gjithmbarshme.

Propozimi i parafolësit nuk u miratua ngase për ishin 5 vota, 5 vota kundër dhe 1 e përmbajtur, për shkak të votave të barabarta vota shtesë e kryesuesit ishte vendimtare.

Pas votimit u konstatua se projektbuxheti së bashku me Rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme, Kuvendit me shumicë votash përkatësisht 6 vota për dhe 5 vota kundër, i rekomandohet për shqyrtim, me plotësim:

Listës së projekteve prioritare, në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, i shtohet projekti nr. 28, përkatësisht Rregullimi i shtratit të lumenit Llap në qytet, 20.000 €, mjete të cilat merren nga projekti nr. 27, Projektet e papërfunduara.

Projekti në numrin rendor 22 asfaltimi i rr.fsh. Lupç – Mjac, të korrigohet Lupç e Majac.

Në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të shtohet projekt i ri, nr. 35, Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Dyz në vlerë 37,000 €

Në kuadër të Drejtorisë së Administratës të bëhen korrigjime si vijon: në projektet e ndërtimit të Zyrës së Vendit për vitin 2015, në vend të fshatit Batllavë të jetë fshati Orllan, ndërsa në vitin 2016, në vend të ndërtimit të Zyrës së Vendit në fshatin Lluzhan të jetë në fshatin Gllamnik.

- 4. Propozimi i Vendimit për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim**

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, i paraqiti sqarimet lidhur me propozimin e këtij vendimi.

Pas votimit u konstatua se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

- 5. Propozimi për lejimin e inicimit të procedurës për këmbimin e pronës komunale në emër të SHFMU “Kadri Kadriu” me pronë private**

z. Abaz Llugaliu, e paraqiti fjalën hyrëse.

Pas votimit u konstatua se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

- 6. Propozimi i vendimeve për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në Tokë ndërtimore (Sipas kërkesave të Salih Tullarit – Tërrnavë dhe Naip Plakollit – Letanc)**

Propozimet e këtyre vendimeve njëzëri i rekomandoohen Kuvendit për shqyrtim.

7. Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 15.00'

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-83089
Podujevë,
26 shtator 2014**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**